

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës
Komora inženjera Republike Kosovo
Chamber of Engineers of the Republic of Kosovo

Nr. i Prot.	<u>439/25</u>
Org. Jendrica	<u>01RK</u>
Org. Unit	
Nr. i faqes	<u>1</u>
Br. Stranica	
Nr. Pages	
PRISHTINË / A	
No.1	

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

E LIDHUR NDËRMJET

ODA E INXHINIERËVE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS

DHE

KOMUNA E PEJËS

Në përputhje me: Ligjin Nr. 08/L-012 “Për Odat e Arkitektëve dhe Inxhinierëve në Fushën e Ndërtimit”(OIRK); Statutin dhe aktet e brendshme të Odës së Inxhinierëve të Republikës së Kosovës; Statutin e Komunës së Pejës, miratuar sipas Ligjit Nr.03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale; si dhe në frymën e bashkëpunimit institucional ndërmjet institucioneve publike dhe organizatave profesionale:

Oda e Inxhinierëve të Republikës së Kosovës (OIRK) dhe Komuna e Pejës, lidhin këtë Marrëveshje Bashkëpunimi në fushën e inxhinierisë, zhvillimit urban dhe sigurisë në ndërtim.

Neni 1

Qëllimi i Marrëveshjes

Qëllimi i kësaj marrëveshjeje është vendosja e bashkëpunimit ndërmjet OIRK dhe Komunës së Pejës për:

- Promovimin e standardeve të larta profesionale dhe etike në projektet komunale;
- Angazhimin e inxhinierëve të licencuar në punët komunale të ndërtimit dhe infrastrukturës;
- Mbështetjen për Edukimin e Vazhdueshëm Profesional (EVP) të inxhinierëve të licencuar që janë anëtarë të OIRK dhe të angazhuar në stafin teknik komunal;
- Zhvillimin e praktikës profesionale dhe mentorimin e të diplomuarve në inxhinieri;
- Këshillim dhe përkrahje për zbatimin e legjislacionit teknik dhe ndërtimor në nivel lokal.

Neni 2

Fushat e Bashkëpunimit

Palët pajtohen të bashkëpunojnë në këto fusha:

1. Këshillim teknik nga OIRK në fazat e planifikimit dhe zbatimit të projekteve komunale;
2. Pranim i praktikantëve të OIRK për zhvillimin e praktikës profesionale në kuadër të zyrave komunale;
3. Shfrytëzim pa kosto i hapësirave komunale për trajnime dhe aktivitete të edukimit të vazhdueshëm profesional (EVP), me dakordim paraprak;
4. Organizim i aktiviteteve të përbashkëta si punëtori, seminare dhe tryeza me interes profesional;
5. Pjesëmarrje e OIRK në komisionet për vlerësimin e projekteve ndërtimore dhe mbikëqyrjen e zbatimit teknik;
6. Bashkëpunim në hartimin dhe shqyrtimin e politikave të ndërtimit dhe planifikimit hapësinor.

Neni 3

Koordinimi dhe Zbatimi

Secila palë do të caktojë nga një koordinator zyrtar për zbatimin e kësaj marrëveshjeje, të cilët do të identifikojnë aktivitetet përkatëse, do të koordinojnë zbatimin dhe do të raportojnë periodikisht për progresin.

Neni 4

Zbatimi i detyrueshëm i licencës profesionale për Inxhinierët

Në përputhje me Ligjin Nr. 08/L-012, Statutin e OIRK-së, dhe Listën e Distribimit të Ministrisë së Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës me nr. protokolli 841/24, nga data 30 maj 2025, në të gjitha projektet ndërtimore, urbane, infrastrukture dhe teknike në territorin e Komunës së Pejës dhe tërë Republikën e Kosovës:

- Nuk do të pranohen për shqyrtim apo zbatim asnjë projekt teknik i hartuar apo i nënshkruar nga persona pa licencë të vlefshme profesionale të lëshuar nga OIRK;
- Mbikëqyrja teknike dhe drejtimi i punimeve do të bëhen vetëm nga profesionistë të licencuar sipas kategorive të përcaktuara nga OIRK;
- Komuna e Pejës obligohet të verifikojë statusin e licencës së profesionistëve përmes sistemit elektronik të OIRK-së dhe në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi;
- Çdo shërbim inxhinierik pa licencë do të konsiderohet në kundërshtim me legjislacionin dhe do të refuzohet nga organet kompetente komunale.

Neni 5

Kohëzgjatja e Memorandumit të Bashkëpunimit

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi shpreh vullnetin e lirë të palëve për bashkëpunim ndër-institucional. Kjo marrëveshje është detyruese për të dyja palët dhe e vlefshme për një periudhë tre (3) vjeçare nga data e nënshkrimit.

Neni 6

Kopjet dhe Gjuha e Marrëveshjes së Bashkëpunimit

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit është hartuar në dy kopje origjinale, që përmban tekstin në gjuhën shqipe. Secila palë do të ketë nga një kopje origjinale të nënshkruar.

Neni 7
Amandamentimi i marrëveshjes

Gjatë zbatimit të kësaj Marrëveshje, në rast se palët konstatojnë se është e nevojshme plotësimi, ndryshimi apo amandamentimi i marrëveshjes, atëherë një gjë e tillë do të bëhet në formë të shkruar dhe do të konsiderohet si aneks i kësaj marrëveshjeje.

Neni 8
Zgjidhja dhe përfundimi i Marrëveshjes

Në çdo rast të mosmarrëveshjeve, interpretimeve apo pikëpamjeve të ndryshme ndërmjet palëve, do të zhvillohen përpjekjet për arritjen e pajtimit të ndërsjellë, përmes bisedimeve.

Marrëveshja mund të përfundojë në çdo kohë. Përfundimi i marrëveshjes duhet t'i paraprijë njoftimi me shkrim, 30 ditë përpara, nga pala tjetër duke i shpjeguar arsyet e përfundimit të bashkëpunimit.

Neni 9
Dispozita Përfundimtare

Çdo çështje që nuk është e rregulluar shprehimisht me këtë Marrëveshje Bashkëpunimi do të trajtohet në frymën e bashkëpunimit dhe mirëkuptimit të ndërsjellë. Marrëveshja do të zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe dokumentet themeltare të të dy institucioneve.

Neni 10
Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje e Bashkëpunimit hyn në fuqi në datën e nënshkrimit nga palët.

PALËT NËNSHKRUESE

Arsim Rapuca

Kryetar i Odës së Inxhinierëve
të Republikës së Kosovës



Gazmend Muhaxheri

Kryetar i
Komunës së Pejës



Prishtinë,
Data 23 qershor 2025